



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DOKUMENTAT STANDARDE
TË PROCEDURËS SË HAPUR
MALLRA ¹

“BLERJE KARBURANTI, PËRVEÇ JET A1”, NDARË NË 7 (SHTATË) LOTE

I NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax +355 42 247 865
Personi përgjegjës: **Sigi ZAIMI** Sigi.Zaimi@mb.gov.al
Faqja në Internet www.abp.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
X	
Njesi e qeverisjes vendore	Tjetër

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo **X**

Seksioni 2. Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-56143-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit I: REF-56145-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit II: REF-56147-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit III: REF-56149-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit IV: REF-56151-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit V: REF-56153-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit VI: REF-56155-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit VII: REF-56157-04-14-2020

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
X				

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po **X** Jo

2.4 Lloji i Marreveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë X

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër.

- Duke qenë se procedura e prokurimit është e ndarë në 7 lote, **jemi përpara rastit të marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara**, parashikuar në paragrafin 3, të pikës 3 të nenit 47 të RPP-së: “*Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.*”
- Duke qenë se secili lot konsiderohet si procedurë më vete, në mbështetje të nenit 35/1 të LPP, nenit 41 e në vijim të RPP, si dhe udhëzimeve e rekomandimeve të APP-së për marrëveshjet kuadër, organi qendror blerës arsyeton se:
- Për secilin lot, organi qendror blerës do të lidhë marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, në emër e për llogari të autoriteteve kontraktore për të cilat zhvillon procedurën. Qëllimi është vendosja e kushteve të njëjta për lidhjen e kontratave, gjatë periudhës kohore të marrëveshjes kuadër. Ky objekt prokurimi zhvillohet në mënyrë të përqëndruar dhe organi qendror blerës ka unifikuar specifikimet teknike si dhe cmimet. Kjo marrëveshje kuadër është e përshtatshme për këtë lloj malli.

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: 1(një) për secilin Lot. (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoriteteve Kontraktore të përcaktuara në pikën 2.7 të DST-ve, me operatorin ekonomik të suksesshëm. Dhënia e kontratave do të behet nga Autoritetet Kontraktore të përcaktuara në pikën 2.7 të DST-ve. Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje Ne rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasi të përkatëse.
-----	--	--

Dokumentat Standarde të Tenderit

		Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues të lotit perkates, te jape oferten e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet ne forme te shkruar, ose elektronike (email, fax, etj.) dhe ne çdo rast duhet te dokumentohet dhe te behet pjese e dosjes se procedures. Sasitë e parashikuara e kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara. (por ne cdo rast brenda vleres se perlllogaritur te marreveshjes kuader). Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj. Çmimet për njësi janë percaktuar në Formularin e Cmimit të Ofertës. Çmimet e njërive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.
--	--	--

2. 7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: Organi Qendror Blerës, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në emër dhe për llogari të autoriteteve kontraktore si më poshtë:

- **Për Lotin I.** “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku janë përfshirë kërkesat e 8 (tetë) autoriteteve kontraktore, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 43,320,549 (dyzet e tre milion e treqind e njëzet mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH:
 1. **Instituti i Shëndetit Publik**, me fond limit 5,813,000 (pesë million e tetëqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Malësi e Madhe**, me fond limit 2,350,000 (dy milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 3. **Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor**, me fond limit 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë pa TVSH.
 4. **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut**, me fond limit 1,613,469 (një milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
 5. **Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë**, me fond limit 3,544,080 (tre milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.
 6. **Spitali Rajonal Vlorë**, me fond limit 11,300,000 (njëmbëdhjetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH.
 7. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë**, me fond limit 4,500,000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
 8. **Operatori I Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor**, me fond limit 2,200,000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH.

- **Për Lotin II.** “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite, ku janë përfshirë kërkesat e 2 (dy) autoriteteve kontraktore, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 45,939,999 (dyzet e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;
 - 1. **Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore**, me fond limit 39,690,000 (tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 - 2. **Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit**, me fond limit 6,249,999 (gjashtë milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë)
- **Për Lotin III.** “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku është përfshirë kërkesa e 1 (një) autoriteti kontraktor, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 4,500,000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
 - 1. **Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor**, me fond limit 4,500,000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
- **Për Lotin IV.** “Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku janë përfshirë kërkesat e 4 (katër) autoriteteve kontraktore, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 126,758,723 (njëqind e njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.
 - 1. **Spitali Rajonal Vlorë**, me fond limit 7,500,000 (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
 - 2. **Spitali Rajonal Shkodër**, me fond limit 20,160,000 (njëzet milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 - 3. **Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"**, me fond limit 96,098,723 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.
 - 4. **Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë**, me fond limit 3,000,000 (tre milion) lekë pa TVSH.
- **Për Lotin V.** “Lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial (solar)” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku janë përfshirë kërkesat e 3 (tre) autoriteteve kontraktore, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 13,799,333 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
 - 1. **Spitali Lushnje**, me fond limit 7,631,000 (shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.
 - 2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kolonjë**, me fond limit 3,333,333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
 - 3. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pukë**, me fond limit 2,835,000 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.
- **Për Lotin VI.** “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku është përfshirë kërkesa e 1 (një)

autoriteti kontraktor, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 19,912,031 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me fond limit 19,912,031 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

- **Për Lotin VII.** “Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, ku është përfshirë kërkesa e 1 (një) autoriteti kontraktor, fondi limit i marrëveshjes kuadër është: 401,033,215 (katërqind e një milion e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

1. Komanda e Forcës Detare, me fond limit 401,033,215 (katërqind e një milion e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2.8 Përshkrim i shkurtër i marrëveshjes kuadër:

1. Fondi marrëveshjes kuadër: **655,263,850** (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.
2. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit
3. Objekti i marrëveshjes kuadër: “**Blerje Karburanti, përveç Jet A1**”, ndarë në 7 (shtatë) lote.

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

--

- **Për Lotin I. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin II. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”,** afati i marrëveshjes kuadër është 3 (tre) vite;
- **Për Lotin III. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin IV. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin V. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (solar)”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.
- **Për Lotin VI. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.
- **Për Lotin VII. “Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76”,** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të marrëveshjes kuadër:

Në të gjitha adresat, godinat dhe territoret në të cilat Autoritet Kontraktore të përcaktuara në pikën 2.7 të DT-së. (sipas Loteve) kanë vendndodhjet dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Për Lotin VI.

Në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë si dhe në 23 (njëzetë e tre) IEVP-të si vijon:

- 1.1. I.E.V.P - Fier
- 1.2. I.E.V.P "Jordan Misja" - Tiranë
- 1.3. I.E.V.P "Ali Demi" - Tiranë
- 1.4. I.E.V.P "Mine Peza" - Tiranë
- 1.5. I.E.V.P Vaqarr - Tiranë
- 1.6. I.E.V.P - Burrel
- 1.7. I.E.V.P - Peqin
- 1.8. I.E.V.P - Rrogozhinë
- 1.9. I.E.V.P - Lezhë
- 1.10. I.E.V.P - Tepelenë
- 1.11. I.E.V.P - Lushnjë
- 1.12. I.E.V.P - Krujë
- 1.13. I.E.V.P - Vlorë
- 1.14. I.E.V.P - Durrës
- 1.15. I.E.V.P - Korçë
- 1.16. I.E.V.P - Berat
- 1.17. I.E.V.P - Fushë Krujë
- 1.18. I.E.V.P - Kukës
- 1.19. I.E.V.P - Sarandë

- 1.20. I.E.V.P - Tropojë
- 1.21. I.E.V.P “Të Miturit” - Kavajë
- 1.22. I.E.V.P - Elbasan
- 1.23. I.E.V.P - Shkodër

2.11 Ndarja në LOTE:

Po X Jo

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve:

- **Loti I. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **43,320,549** (dyzet e tre milion e treqind e njëzet mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH;
- **Loti II. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **45,939,999** (dyzet e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;
- **Loti III. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **4,500,000** (katër milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
- **Loti IV. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **126,758,723** (njëqind e njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti V. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (solar)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **13,799,333** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti VI. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **19,912,031** (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.
- **Loti VII. “Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **401,033,215** (katërqind e një milion e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (*nëse ka*):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Dokumentat Standarde të Tenderit

Po Jo X

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo X

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: _____

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo

Shenime te tjera

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo X

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo X

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimi sipas shtojcës 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës¹: 2 % (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 4. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **2% e fondit të marrëveshjes kuadër për secilin Lot Lekë** (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:

- Loti I. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, 866,410.98 Lekë;
- Loti II. Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite, 918,799.98 Lekë;
- Loti III. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, 90,000 Lekë;
- Loti IV. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, 2,535,174.46 Lekë;
- Loti V. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial(solar)”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, 275,986.66 Lekë;
- Loti VI. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, 398,240.62 Lekë;
- Loti VII. “Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (vite), 8,020,664.3 Lekë.

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: ”Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po

Jo

X

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anuluar

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit të anuluar _____

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar _____

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët **X**

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, çmimi më i ulët bazohet në:

- i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të

luhatjes se çmimeve.

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **01/06/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **01/06/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**

Vendi: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brëndshme, Tiranë.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 (e shprehur në ditë)

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht	X
Tjetër	_____		

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po	Jo	X
----	----	----------

Nëse Po

Monedha	_____	Çmimi	_____
---------	-------	-------	-------

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë.

Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **15.04.2020**

**Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në
Buletinin e Njoftimeve Publike**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax +355 42 247 865
Personi përgjegjës: **Sigi ZAIMI** Sigi.Zaimi@mb.gov.al
Faqja në Internet www.abp.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar"

3. Numri i referencës së procedurës: REF-56143-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit I: REF-56145-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit II: REF-56147-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit III: REF-56149-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit IV: REF-56151-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit V: REF-56153-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit VI: REF-56155-04-14-2020

Numri i referencës së Lotit VII: REF-56157-04-14-2020

4. Objekti i marrëveshjes kuadër: "Blerje Karburanti, përveç Jet A1", ndarë në 7 (shtatë) lote si më poshtë:

- **Për Lotin I. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin II. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)",** afati i marrëveshjes kuadër është 3 (tre) vite;
- **Për Lotin III. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin IV. "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite;
- **Për Lotin V. "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (solar)",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.
- **Për Lotin VI. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.
- **Për Lotin VII. "Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76",** afati i marrëveshjes kuadër është 2 (dy) vite.

5. Fondi i marrëveshjes kuadër: 655,263,850 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH limit, i ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti I. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)",** me afat të marrëveshjes

kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **43,320,549** (dyzet e tre milion e treqind e njëzet mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH;

- **Loti II. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **45,939,999** (dyzet e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;
- **Loti III. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fondi limit të marrëveshjes kuadër: **4,500,000** (katër milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
- **Loti IV. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (Gazoil < 0.1, Gazoil > 0.1, mazut)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **126,758,723** (njëqind e njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti V. “Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial (solar)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fondi limit të marrëveshjes kuadër: **13,799,333** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti VI. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fondi limit të marrëveshjes kuadër: **19,912,031** (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.
- **Loti VII. “Furnizim me lëndë djegëse Naftë-F76”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **401,033,215** (katërqind e një milion e tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 01/06/2020 (dd/mm/vvvv) Ora: 12:00 Vendi: www.app.gov.al

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 01/06/2020 (dd/mm/vvvv) Ora: 12:00 Vendi: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brëndshme, Tiranë.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

- 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit
- 1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezultojnë të vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.
- 1.6 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**
 - a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT ose Shtojcës 2 të DT (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje).
 - b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
_____,
_____,
_____.
 - c) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1.
 - ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 8.
 - d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës“, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me

fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

- 1.7 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.
- 1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e mallrave; Nr e Njoftimit _.

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____”

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.

- 1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.

Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike

- 2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të levrohen, sasitë dhe çmimin e tyre.
- 2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 2.4. Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkursi midis operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër.
- 2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit

kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave

3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

- i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;

- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min k1} \times P_{max k1} / O_{k1}$$

Pk1	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më mëposhtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*

3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta

M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n – Numri i Ofertave të vlefshme

Z_M – Zbritja e Mundshme

$$M_0 = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% M_0$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet $< Z_M$, si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.4. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. Nënshkrimi i Kontratës

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 14. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- i. garanci bankare
- ii. garanci sigurimi

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje

Shtojca 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur

Shtojca 3: Ftesa për Ofertë në rastin e Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 7: Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme

Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marrëdhëniet e punës

Shtojca 9: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes

Shtojca 10: Specifikimet teknike

Shtojca 11: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër

Shtojca 12: Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit

Shtojca 13: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 15 Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomike të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 17: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 18: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar

Shtojca 18/1: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor

Shtojca 21: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 23: Formulari i Njoftimit të Anulimit

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Marzhi ynë i fitimit i shprehur në përqindje është si më poshtë:

1	2	3	5
Nr	Përshkrimi i mallrave	Marzhi i fitimit i shprehur në përqindje	Afati i levritimit

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 2/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për

Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 3

[Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për furnizimin e mallrave të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).

Vendi i Dorëzimit të Mallit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Malli duhet të dorëzohet brenda datës _____

Oferta duhet të paraqitet

.....[Jep
adresën e saktë]

Përpara

.....
[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Me shkrim

elektronike (email, fax, etj)

Shtojca 4.

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të siguruar]* ka derdhur një depozitë pranë *[emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit]* me një vlerë prej *[monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës ose ftesën për tender]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

